



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2008

01 Janar 2008 - 31 Dhjetor 2008

**Shkurt 2009
Prishtinë**

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	3
1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.....	4
2. Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2008	5
2.1. Prokurimet Publike sipas autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2008.....	6
2.2. Kontratat e nënshkruara sipas autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2008 sipas vlerës	7
2.3. Prokurimet Publike sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2008.....	9
2.4. Kontratat e nënshkruara sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2008.....	10
2.5. Prokurimet Publike sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2008	12
2.6. Kontratat e nënshkruara sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2008	13
2.7. Prokurimet Publike sipas llojit të vlerës së prokurimit gjatë vitit 2008	15
2.8. Kontratat e nënshkruara sipas llojit të vlerës së prokurimit gjatë vitit 2008.....	16
2.9. Prokurimet Publike sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2008.....	18
2.10. Kontratat e nënshkruara sipas vlerës dhe procedurave të prokurimit gjatë vitit 2008....	9
2.11. Prokurimet Publike sipas llojit dhe procedurave të prokurimit gjatë vitit 2008.....	21
2.12. Prokurimet Publike sipas vlerës së përlogaritur dhe vlerës së kontratës së nënshkruar gjatë vitit 2008	22
2.13. Kontratat e nënshkruara sipas operatorve ekonomik gjatë vitit 2008.....	23
2.14. Kontratat e nënshkruara në bazë të vlerës dhe operatorve ekonomik gjatë vitit 2008...	24
2.15. Kontratat e nënshkruara sipas afateve të publikimit gjatë vitit 2008.....	25
2.16. Kontratat e nënshkruara sipas afatit kohor në bazë të vlerës gjatë vitit 2008.....	27
2.17. Kontratat e nënshkruara sipas kriterit për dhënje kontratë gjatë vitit 2008.....	28
2.18. Kontratë e nënshkruar sipas vlerës dhe kriterit për dhënje kontratë gjatë vitit 2008....	29
2.19. Prokurimet publike në raport me BPV në Kosovë gjatë vitit 2008.....	30
2.20. Kontratat e nënshkruara në Kosovë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2008.....	31
2.21. Autoritetet kontraktuese me vlerë të përgjithshme të kontratave të nënshkruara që e tejkalojnë vlerën 3.000.000,00 gjatë vitit 2008.....	35
2.22. Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 3.000.000,00 nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2008.....	36
3. Aktivitetet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.....	39
4. Rekomandimet për përmirimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.....	46
5. Aneks: Shpenzimet Buxhetore të KRPP-së për vitin 2008	48

H Y R J E

Duke u bazuar në Nenin 82.2 (i), të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 02/L-99, të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik do të përgatisë dhe dorëzojë Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor në të cilin analizohen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e Ligjit për Prokurim Publik sipas nevojës. Ky raport duhet t'i dërgohet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës më së voni deri në fund të Shkurtit të vitit vijues.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duke u bazuar në kërkesën e nenit të lartshënuar të Ligjit për Prokurim Publik, me kohë ka përgatitur Raportin vjetor për vitin 2008, dhe të njëjtin ua dërgon Qeverisë së Kosovës, si dhe Kuvendit të Kosovës.

Ky raport është pregaditaur në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik Nr. 02/L-99, duke paraqitur një analizë mjaftë të detalizuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 Janar 2008 - 31 Dhjetor 2008.

Pregaditja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 82.2 (h) të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet të grumbulloj, analizoj dhe publikoj informacionet për procedurat e prokurimit publik, dhe kontratat publike të dhëna.

Është ky viti i katërt me radhë që KRPP-ja përgatitë një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë, dhe ta kompletojë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë më të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2008. Ky raport do të jetë mjaftë i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit. Raporti do të jetë i dobishëm edhe për donatorët e ndryshëm që mendojnë të investojnë në të ardhmen në Kosovë, pasi që duke u bazuar në të dhënat e Raportit mund të konstatohet se 77.40 % të buxhetit për prokurime publike në Kosovë gjatë vitit 2008 janë shpenzuar përmes procedurave të hapura, që njihen si procedurat më transparente.

1. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i Kosovës është themeluar duke u bazuar në nenin 81 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 2003/17, i cili ka hyrë në fuqi më 09 Qershor 2004. KRPP-ja ka filluar të funksionojë më 03 Shkurt të vitit 2005. Me amandamentimin e Ligjit për Prokurim Publik, nga ana e Kuvendit të Kosovës më 08 Shkurt 2007, të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20 më 06 Qershor 2007, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ndryshojnë duke iu përshtatur kërkesave që dalin nga dy Direktivat e Prokurimit të BE-së Nr. 2004/17 dhe 2004/18, si dhe rrethanave që kanë ndodhur në Kosovë në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës 2004-2006.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës Nr. 02 - L/99, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik :

- Është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë;
- Vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së;
- Nxjerrë dhe publikon interpretime me shkrim, si dhe ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin e dispozitave të LPP-së;
- Krijon dhe mirëmban faqen informative në internet që i ofron publikut qasje të pakufizuar në të dhënat mbi prokurimin publik në Kosovë, si dhe mundëson përmirësimin e publikimeve të kërkuara sipas LPP-së;
- Mbështet IKAP-in dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar trajnimin dhe aftësimin e zyrtarëve të prokurimit publik në tërë Kosovën;
- Të fillojë dhe mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik dhe komunikimin brenda fushës së prokurimit publik;
- Të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe të gjitha kontratat publike të dhëna në Kosovë;
- Bashkëpunon me organizatat tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik;
- Propozon Qeverisë dhe Kuvendit masat për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, dhe përmirësimin e këtij Ligji;

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik udhëhiqet nga Bordi i cili përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Me amandamentimet e bëra në LPP parashihet që në të ardhmen Bordi i KRPP-së të ketë 3 anëtarë të përhershëm, kurse çdo anëtar i KRPP-së që është në detyrë që prej 31 Dhjetorit 2006 do të vazhdojë të shërbejë në atë detyrë deri në mbarimin e mandatit të tij, siç parashikohet në legjislacionin e prokurimit që ishte në fuqi në kohën e emërimit të tij.

2. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2008

Duke u bazuar në Nenin 82.2. (n) të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 02-L/99, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të përgaditë dhe mbajë një listë të plotë të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë që janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik. Më 01 Janar 2008 në Kosovë kane ekzistuar 137 autoritete kontraktuese, kurse më 31 dhjetor 2008 numri i këtyre autoriteteve kontraktuese është rritur në 142.

Përmes raporteve vjetore për kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë Janarit 2009, i kanë dërguar në mënyrë elektronike, departamenti i TI-së ka përgatitur raportin përmbledhës vjetor për të gjitha prokurimet publik të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2008.

Nga gjithësejt 142 autoritete kontraktuese sa kanë ekzistuar në Kosovë në fund të vitit 2008, 135 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore në KRPP, 4 autoritete kontraktuese nuk kanë zhvilluar asnjë aktivitet të prokurimit gjatë vitit 2008, kurse 3 autoritete kontraktuese nuk i kanë dërguar raportet vjetore fare. Autoritetet kontraktuese të cilat nuk i kane dorëzuar raportet vjetore, janë vetëm tri komuna nga pjesa veriore e Kosovës - komuna e Zveqanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit . Buxheti i paraparë të shpenzohet për prokurime për këto tri komuna sipas BKK-së gjatë vitit 2008 është 1.304.524 €, e që marrin pjesë vetëm me 0,16% në vlerën gjithëmbarshe të kontratave të nënshkruara publike për vitin 2008.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2008 në tërë Kosovën janë nënshkruar 14317 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës duke përfshirë të gjitha llojet e vlerave të prokurimit .

Në vazhdim të raportit do të paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008. Duke pasur për bazë raportin e vitit paraprak ku për herë të parë ishte përgatitur një raport i përgjithshëm mbi aktivitetet e prokurimit të zhvilluara në Kosovë, i bazuar sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim do të paraqet aktivitetet e prokurimit, gjegjësisht të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke pasqyruar një analizë të prokurimeve publike sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, operatorëve ekonomik të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kritereve të shpërbllimit me kontratë. Pra, raporti në vazhdim do të pasqyroj të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2008 në Kosovë, duke analizuar dhe krahasuar me vitin paraprak, ashtu që të shohim trendin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara në Kosovë.


2.1. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS AUTORITETEVE KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Autoritetet kontraktuese:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 - (%)
Qeveritare	10622	10882	2.45
Kompani publike	4578	3431	-25.05
Tjera	18	4	-77.78
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92

Tabela 1

Në bazë të kontratave të nënshkruara sipas autoriteteve kontraktuese në tabelën 1 dhe grafikun 1, shihet se te njësite buxhetore – Qeveritare gjatë vitit 2008 është rritur numri i kontratave të nënshkruara krahasuar me vitin paraprak për 2,45 %. Te kompanitë publike është zvogëluar numri i kontratave të nënshkruara për 25,05%, derisa te autoritetet tjera OJQ-të, paraqiten vetëm 4 kontrata të nënshkruara, e që krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim të numrit të tyre për 77,78%.


Numri i përgjithshëm i kontratave të nënshkruara duke u bazuar në Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës gjatë vitit 2008 është 14317, e që krahasuar me vitin paraprak paraqitet një zvogëlim i tyre për 5.92 %.



Grafikoni 1

Grafikoni 2 paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 në totalin e tyre sipas llojit të autoriteteve kontraktuese. Organizatat buxhetore qeveritare marrin pjesë me 76,01%, kompanitë publike me 23,96%, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0,03% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara

Struktura e numrit të kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008



Grafikoni 2


2.2. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS AUTORITETEVE KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2008 SIPAS VLERËS

Vlera e kontratave të nënshkuara sipas autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Autoritetet kontraktuese:	Vlera kontratave 2007 (€)	Vlera kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
Qeveritare	187,463,647.57	456,695,720.32	143.62
Kompani publike	213,824,064.35	369,627,159.60	72.87
Tjera	940,724.98	160,682.75	-82.92
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48

Tabela 2

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese sipas kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008, në tabelën 2, dhe grafikonin 3, vlera e prokurimeve të njësite buxhetore – Qeveritare është 456,695,720.32 €, e që krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 143,62 %. Te kompanit publike kjo vlerë është 369,627,159.60 €, ku rritja në përqindje është prej 72,87% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa te autoritetet tjera – OJQ-të, vlera e kontratave të nënshkuara është 160,682.75 €, dhe krahasuar me vitin paraprak paraqitet zvogëlim në përqindje prej 82,92%.


Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2007 dhe 2008



Grafikoni 3

Grafikoni nr. 4 paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së kontratave të nënshkruara sipas vlerës gjatë vitit 2008 në totalin e tyre sipas llojit të autoriteteve kontraktuese. Organizatat buxhetore qeveritare marrin pjesë me 55,26 %, kompanitë publike me 44,72 %, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0,019 % në strukturën e përgjithshme të vlerës së kontratave të nënshkruara.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008




Grafikoni 4

2.3. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Burimet e financimit:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
Të Hyrat vetanake¹	4490	3298	-26.55
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	10501	10875	3.56
Donacione	227	144	-36.56
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92

Tabela 3


Në bazë të burimeve të financimit në tabelën 3, dhe grafikun 5, shihet se nga të hyrat vetanake, gjatë vitit 2008 janë nënshkruar 3298 kontrata, krahasuar me vitin paraprak, paraqitet një zvogëlim prej 26,55% i numrit të kontratave të nënshkruara. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 arrin 10875, krahasuar me vitin paraprak paraqitet një rritje prej 3.56% të numrit të kontratave të nënshkruara, kurse numri i kontratave të nënshkruara të financuara nga donacionet është 144, krahasuar me vitin paraprak shënohet një zvogëlim i tyre prej 36,56%.



Grafikoni 5

¹ Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e kompanive publike

Grafikoni nr. 6 paraqet strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2008. Nga të hyrat vetanake kjo përqindje është 23,00 %, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 76,00 %, kurse nga donacionet vetëm 1,00%.



Grafikoni 6

2.4. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT GJATË VITIT 2008


Vlera e kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Burimet e financimit:	Vlera e kontratave 2007 (€)	Vlera e kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 - (%)
Të Hyrat vetanake²	145,812,848.23	145,264,989.52	-0.38
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	250,156,142.79	676,563,199.06	170.46
Donacione	6,259,445.88	4,655,374.09	-25.63
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48

Tabela 4

Gjatë vitit 2008 sipas burimeve të financimit në tabelën 4, dhe grafikun 7 nga të hyrat vetanake vlera e kontratave të nënshkruara është 145,264,989.52 €, krahasuar me vitin paraprak shënohet një zvogëlim prej 0,38 %. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e


² Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e kompanive publike

kontratave të nënshkruara arrin 676,563,199.06 €, krahasuar me vitin paraprak paraqitet një rritje prej 170,46%, kurse nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 4,655,374.09 €, krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim prej 25,63% ,



Grafikoni 7

Në grafikonin nr. 8 paraqitet pjesëmarrja e kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit. Nga të hyrat vetanake pjesëmarrja është 17,58 %, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, 81,86 % kurse nga donacionet kjo pjesëmarrje është vetëm 0,56%.




Grafikoni 8

2.5. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i prokurimit:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 -(%)
Furnizim	10872	9169	-15.66
Shërbime	3085	3601	16.73
Konkurs i projektimit	60	62	3.33
Punë	1201	1485	23.65
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92


Tabela 5

Në bazë të numrit të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 sipas llojit të prokurimit në tabelën 5, dhe grafikun 9, mund të konstatohet se për furnizime janë nënshkruar 9169 kontrata, apo 15,66% me pak, krahasuar me vitin paraprak, Për shërbime janë nënshkruar 3601 kontrata, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 16,73%, Për konkurse projektimi janë nënshkruar 62 kontrata gjatë vitit 2008, me një rritje krahasuar me vitin paraprak prej 3,33%. Derisa numri i kontratave të nënshkruara për punë gjatë vitit 2008 arrin 1485, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 23,65%.



Grafikoni 9

Grafikoni nr. 10 paraqet strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2008. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 64,04 %, kontratat për shërbime me 25,15%, kontratat për konkurse te projektimit me 0,43 %, kurse kontratat për punë marrin pjesë me 10,37% në numrin e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 .




Grafikoni 10

2.6. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i prokurimit:	Vlera e kontratave 2007 (€)	Vlera e kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 -(%)
Furnizim	242,642,818.13	334,982,809.59	38.06
Shërbime	29,501,718.56	44,243,562.12	49.97
Konkurs i projektimit	4,247,904.02	845,583.04	-80.09
Punë	125,835,996.19	446,411,607.92	254.76
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48


Tabela 6

Në tabelën 6, dhe grafikoni 11 paraqitet vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit, gjatë vitit 2008, për furnizime vlera arrin në 334,982,809.59 €, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 38,06%. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 44,243,562.12 €, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 49,97%. Vlera e kontratave të nënshkruara për konkurse projektimi është 845,583.04€, krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim prej 80,09%, ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 446,411,607.92€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje 254,76%,.



Grafikoni 11

Grafikoni nr 12, paraqet pjesëmarrjen e kontratave të nënshkuara sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 40,53%, kontratat për shërbime me 5,35%, kontratat për konkurse të projektimit me 0,102%, ndërsa kontratat për punë me 54,01%.




Grafikoni 12

2.7. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS LLOJIT TË VLERËS SË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas vlerës së prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i vlerës së prokurimit:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 -(%)
Vlerë e madhe	668	858	28.44
Vlerë e mesme	2226	2557	14.87
Vlerë e vogël	4893	4429	-9.48
Vlerë minimale	7431	6473	-12.89
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92


Tabela 7

Prokurimet publike të ndara sipas llojit të vlerave gjatë vitit 2008 në tabelën 7 dhe grafikun 13 tregojnë se sipas vlerës së madhe, numri i kontratave të nënshkruara është 858 dhe duke krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të numrit të këtyre kontratave për 28,44%. Numri i kontratave të nënshkruara me vlerë të mesme arrin 2557, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 14,87%. Numri i kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 4429, gjegjësisht në krahasim me vitin paraprak shënon një zvogëlim prej 9,48% të numrit të kontratave të nënshkruara, çka paraqet një trend pozitiv. Gjithashtu kontratat e nënshkruara me vlerë minimale janë 6473, krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim të numrit të tyre për 12,89 %.



Grafikoni 13

Në bazë të grafikut nr.14, shihet se gjatë vitit 2008, kontratat me vlera të mëdha marrin pjesë me 6,00% , në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë me 18,00%, ato me vlera të vogla marrin pjesë me 31 %, kurse te kontratat me vlera minimale pjesëmarrja është 45 % ne . strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008.



Grafikoni 14


2.8.KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas vlerës së prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i vlerës së prokurimit:	Vlera e kontratave 2007 (€)	Vlera e kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
Vlerë e madhe	286,532,415.11	680,198,284.54	137.39
Vlerë e mesme	89,841,042.31	119,156,951.86	32.63
Vlerë e vogël	22,826,536.65	23,599,031.30	3.38
Vlerë minimale	3,028,442.83	3,529,294.97	16.54
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48

Tabela 8


Prokurimet publike të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave të nënshkruara, në tabelën 8 dhe grafikun 15, na paraqesin se sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 është 680,198,284.54€ dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 137,39%, Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme gjatë vitit 2008 arrijnë vlerën 119,156,951.86€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 32,63%, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 23,599,031.30€, në krahasim me vitin paraprak kemi rritje prej 3,38%, derisa krahasuar me dyfishim të vlerës së prokurimeve në raport me vitin paraprak, kjo tregon pra një trend mjaft pozitiv të zvogëlimit të këtyre prokurimeve. Vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale gjatë vitit 2008 është 3,529,294.97€, krahasuar me vitin

paraprak kemi një rritje prej 16,54%, ndërsa krahasuar me dyfishim të vlerës së prokurimeve në raport me vitin paraprak, kjo tregon gjithashtu një trend mjaft pozitiv të zvogëlimit të këtyre prokurimeve.



Grafikoni 15

Në bazë të grafikoni nr 16 vërehet se pjesëmarrja e kontratave sipas vlerës me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008 është 82,30%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkuara me 14,42%. Kontratat me vlera të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkuara me 2,86%, derisa kontratat me vlera minimale marrin pjesë me 0,42% .




Grafikoni 16

2.9. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i procedurave:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
E hapur	2877	3607	25.37
E kufizuar	28	-	-100.00
E negociuar	416	485	16.59
Kuotimi i çmimeve	4406	3726	-15.43
Procedurë për vlerë minimale	7431	6437	-13.38
Konkurs projektimi	60	62	3.33
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92


Tabela 9

Krahasimi i prokurimeve publike të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën 9, dhe grafikun 17, paraqesin numrin e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2008 e që është 3607, duke krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje për 25,37%. Derisa gjatë vitit 2008 nuk kemi asnjë kontratë të prezantuar nga autoritetet kontraktuese sipas procedurës së kufizuar. Numri i kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar gjatë vitit 2008 është 485, në krahasim me vitin paraprak kemi shtim të numrit të kontratave në fjalë për 16,59%. Numri i kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve gjatë vitit 2008 arrin në 3726, me një zvogëlim krahasuar me vitin paraprak prej 15,43%, Numri i kontratave të nënshkruara sipas procedurës me vlerë minimale gjatë vitit 2008 është 6437, krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim të numrit të kontratave të nënshkruara për 13,38%, Dhe numri i kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi gjatë vitit 2008 është 62, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 3,33%,



Grafikoni 17

Në bazë të grafikonit nr.18, shihet se pjesëmarrja e procedurave të hapura në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara për vitin 2008 është 25,19% %. Pjesëmarrja e procedurave të negociuara është 3,39%, kurse pjesëmarrja e procedurave sipas kutimit të çmimeve është 26,03%. Procedurat sipas vlerave minimale marrin pjesë me 44,96%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0,43 % në kontratat e gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2008.



Grafikoni 18

2.10. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2007 (€)	Vlera e kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
E hapur	326,326,955.34	639,679,203.78	96.02
E kufizuar	1,772,982.62	-	-100.00
E negociuar	50,153,766.34	164,156,690.61	227.31
Kuotimi i çmimeve	20,765,629.23	18,288,457.42	-11.93
Procedurë për vlerë minimale	3,028,442.83	3,513,627.82	16.02
Konkurs projektimi	180,660.54	845,583.04	368.05
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48

Tabela 10

Analiza e prokurimeve publike të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën 10, dhe grafikonin 19 tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2008 është 639,679,203.78€, dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje evidente prej 96,02%, Sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2008 autoritetet kontraktuese nuk kanë zhvilluar prokurime. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar gjatë vitit 2008 është 164,156,690.61€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 227,31%, Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve gjatë vitit 2008 është 18,288,457.42€, gjegjësisht 11,93% më e vogël se vitin paraprak, Kurse sipas procedurës për vlerë minimale vlera e kontratave gjatë vitit 2008 është 3,513,627.82€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 16,02%, por në raport me dyfishimin e vlerës së kontratave gjatë vitit 2008, kemi një trend pozitiv të zvogëlimit të vlerës së kontratave sipas kësaj procedure. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi gjatë vitit 2008 është 845,583.04€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 368,05%.





Tabela 19

Në bazë të grafikonit nr. 20, shihet se pjesëmarrja e procedurave të hapura në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara sipas vlerës për vitin 2008 është prej 77,40 %.

Pjesëmarrja e procedurave të negociuara është 19,86%, kurse pjesëmarrja e procedurave sipas kutimit të çmimeve është 2,21%. Procedurat sipas vlerave minimale marrin pjesë me 0,43%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0,10 % në kontratat e gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2008.




Grafikoni 20

2.11. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2008

	Procedurat e prokurimit						
Lloji prokurimit	E hapur	E kufizuar	E negociuar	Kuotim i çmimeve	Vlera minimale	Konkurs Projektimi	Gjithësejt:
Furnizim	169,188,802.95	-	150,042,019.87	13,077,724.88	2,674,261.89	-	334,982,809.59
Shërbime	27,164,477.62	-	11,338,215.27	4,920,926.73	819,942.50	-	44,243,562.12
Konkurs projektim	-	-	-	-	-	845,583.04	845,583.04
Punë	443,325,923.21	-	2,776,455.47	289,805.81	19,423.43	-	446,411,607.92
Gjithsejtë	639,679,203.78	-	164,156,690.61	18,288,457.42	3,513,627.82	845,583.04	826,483,562.67

Tabela 11

Prokurimet publike të ndara sipas llojit të prokurimit dhe procedurave të prokurimit sipas vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008, në tabelën 11 dhe grafikun 21, tregojnë vlerën e kontratave të nënshkruara duke pasur parasysh kombinimin e llojit të prokurimit dhe llojin e procedurave të përdorura nga autoritetet kontraktuese.



Grafikoni 21

2.12. PROKURIMET PUBLIKE SIPAS VLERËS SË PËRLLLOGARITUR DHE VLERËS SË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR GJATË VITIT 2008

Kursimet e realizuara nga prokurimet gjatë vitit 2007 dhe 2008		
	Viti 2007	Viti 2008
Numri i kontratave të nënshkruara:	15218	14317
Vlera e kontratave të planifikuara	435,952,876.73	900,203,954.31
Vlera e kontratave të nënshkruara	402,228,436.90	826,483,562.67
Kursimet (€)	33,724,439.83	73,720,391.64
Kursimet (%)	8.38	8.92

Tabela 12


Në bazë të kërkesave sipas Nenit 8.2 të LPP-së, çdo autoritet kontraktues para se ta fillojë aktivitetin e prokurimit duhet të sigurohet që mjetet për atë aktivitet të prokurimit janë siguruar duke u bazuar në vlerën parallogaritë të projektit përkatës. Nga tabela 12 shifet se vlera parallogaritë për të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008 ka qenë 900,203,954.31€, ndërsa vlera sipas kontratave të nënshkruara ka qenë 826,483,562.67€. Kursimet e buxhetit në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008 janë 73,720,391.64€, apo shprehur në përqindje kemi një kursim të buxhetit për 8.92%. Kjo vjen si rezultat i zbatimit të procedurave të hapura gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit duke marrë parasysh se 77,40% të buxhetit për prokurime gjatë vitit 2008, janë shpenzuar sipas procedurave të hapura, e që janë procedurat më transparente sipas kërkesave të LPP-së .

2.13. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORVE EKONOMIK GJATË VITIT 2008

a) Numri i kontratave të nënshkruara nga operatorët ekonomik gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Operatorët ekonomik:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
Operatoret vendor	14987	14010	-6.52
Operatoret jo vendor	231	307	32.90
Gjithsejtë :	15218	14317	-5.92


Tabela 13

Duke bërë krahasimin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operator ekonomik vendor dhe jo vendor, në tabelën 13, grafikonin 22 dhe 23, rrjedhë se numri i kontratave të dhëna operatorëve vendor është 14010, krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim të numrit të kontratave për 6,52%, kurse pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 është 98,00%. Derisa numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 nga operatorët jo vendor është 307, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 32,90% të këtyre kontratave dhe me pjesëmarrje prej 2,00% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruar gjatë vitit 2008.



Grafikoni 22

Struktura e numrit të kontratave të nënshkruara sipas operatorve ekonomik- gjatë vitit 2008



Grafikoni 23


2.14. KONTRATAT E NËNSHKRUARA NE BAZE TE VLERËS DHE OPERATORËVE EKONOMIK GJATË VITIT 2008

b) Vlera e kontratave të nënshkruara nga operatorët ekonomik gjatë vitit 2008, krahasuar me vitin 2007			
Operatorët ekonomik:	Vlera e kontratave 2007 (€)	Vlera e kontratave 2008 (€)	Krahasimi i vitit 2007-2008 (%)
Operatorët vendor	272,311,662.18	587,017,393.58	115.57
Operatorët jo vendor	129,916,774.72	239,466,169.09	84.32
Gjithsejtë :	402,228,436.90	826,483,562.67	105.48

Tabela 14


Nga analiza e bërë e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operator ekonomik vendor dhe jo vendor, në tabelën 14, grafikoni 24 dhe 25, rrjedhë se vlera e kontratave të dhëna operatorëve vendor është 587,017,393.58€, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të vlerës së kontratave për 115,57%, kurse pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 është 71,03%. Derisa vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 nga operatorët jo vendor është 239,466,169.09€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 84,32% të vlerës së këtyre kontratave dhe me pjesëmarrje prej 28,97% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas operatorve ekonomik gjatë vitit 2007 dhe 2008



Grafikoni 24

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas operatorve ekonomik- gjatë vitit 2008




Grafikoni 25

2.15. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS AFATEVE TE PUBLIKIMIT GJATË VITIT 2008

a) Numri i kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor gjatë vitit 2008		
Afatet:	Numri i kontratave	Pjesëmarrja në shumën e përgjithshme (%)
Afate normale kohore	13124	91.667
Shkurtim i afatit	1193	8.333
Gjithsejtë :	14317	100.000

Tabela 15

Siç shihet në tabelën 15 dhe grafikun 25, numri i kontratave të publikuara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore është 13124, dhe pjesëmarrje prej 91,667% në numrin e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008. Kurse numri i kontratave të shpallura me shkurtim afati arrin në 1193, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 8,333% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008.



Grafikoni 25

2.16. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR NE BAZE TE VLERËS GJATË VITIT 2008

a) Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor gjatë vitit 2008		
Afatet:	Vlera e kontratave 2008 (€)	Pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme (%)
Afate normale kohore	496,290,782.15	60.05
Shkurtim i afatit	330,192,780.52	39.95
Gjithsejtë :	826,483,562.67	100.00

Tabela 16

Dhe bazuar në tabelën 16 dhe grafikonin 26, vlera e kontratave të publikuara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore është 496,290,782.15€, dhe pjesëmarrje prej 60.05% në vlerën e gjithëmbarshtë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara me shkurtim afati arrin në 330,192,780.52€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 39,85% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008.



Grafikoni 26


2.17. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNJE KONTRATE GJATË VITIT 2008

Numri i kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie kontrate gjatë vitit 2008		
Sipas çmimit	Numri i kontratave	Pjesëmarrja në shumën e përgjithshme (%)
Çmimi më i ulët	13754	96.07
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	563	3.93
Gjithsejtë :	14317	100.000

Tabela 17

Nga tabela 17 dhe grafikoni 27, numri i kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese duke përdorur si kriter për dhënie kontrate çmimin më të ulët është 13754, dhe pjesëmarrje prej 96,07% në numrin e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008. Kurse numri i kontratave të dhëna, ku si kriter është çmimi ekonomikisht më i favorshëm arrin në 563, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 3,93% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008.

Numri i kontratave të nënshkruara sipas kriterit për shpërbllim me kontrata gjatë vitit 2008




Grafikoni 27

2.18. KONTRATË E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS DHE KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE GJATË VITIT 2008

Vlera e kontratave të nënshkuara sipas kriterit për dhënie kontrate gjatë vitit 2008		
Sipas çmimit	Vlera e kontratave 2008 (€)	Pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme (%)
Çmimi më i ulët	465,130,664.48	56.28
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	361,352,898.19	43.72
Gjithsejtë :	826,483,562.67	100.00

Tabela 18


Si shihet në tabelën 18 dhe grafikun 28, vlera e kontratave të nënshkuara nga autoritetet kontraktuese sipas kriterit për dhënie çmimi më i ulët është 465,130,664.48€, dhe pjesëmarrje prej 56,28% në vlerën e gjithëmbarshtë të kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008. Kurse vlera e kontratave të shpallura sipas kriterit për dhënie kontrate çmimi ekonomikisht më i favorshëm arrin në 361,352,898.19€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 43,72% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2008.



Grafikoni 28

2.19. PROKURIMET PUBLIKE NË RAPORT ME BPV NË KOSOVË GJATË VITIT 2008

Vlera e përgjithshme e prokurimeve publike të evidentuara në bazë të raporteve të dërguara nga autoritetet kontraktuese që përfshin numrin prej 14317 kontratave të nënshkruara për periudhën 01.01.2008 - 31.12.2008 është 826,483,562.67 €, çka paraqet 21,99 % të BPV (Bruto Produkti Vendor në vitin 2008 në Kosovë = 3.757.000.000 €.³



Grafikoni 29

³ Burimi : Departamenti i Makroekonomisë - MEF

2.20.KONTRATAT E NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2008

Nr	Autoritetet kontraktuese	Numri i kontratave të nënshkruara ⁴	Vlera e kontratave të nënshkruara (€)	Piesmarrja në vlerën e përgjithshme (%)
1	Administrata Tatimore e Kosovës	82	4,695,220.12	0.568
2	Aeroporti i Prishtinës	210	3,651,147.01	0.442
3	Agjencia per Barazi Gjinore/ZK	43	74,760.65	0.009
4	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	3	257,367.50	0.031
5	Agjencioni i Prokurimit Publik	18	52,020.18	0.006
6	Agjencioni i Veterinarisë	41	1,003,443.09	0.121
7	Agjencioni Kadastral i Kosovës	25	1,122,715.96	0.136
8	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	35	1,046,269.42	0.127
9	Agjencioni Kosovar i Pronës	120	792,642.65	0.096
10	Agjencioni Kunderkorrpcionit	25	92,941.05	0.011
11	Agjencioni Pyjor i Kosovës	25	315,767.29	0.038
12	Akademia e Shkencave dhe Arteve	39	81,566.78	0.010
13	Autoriteti i Aviacionit Civil	11	16,013.54	0.002
14	Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit	17	1,519,185.51	0.184
15	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	119	904,499.31	0.109
16	Bibloteka Kombtare dhe Universitare e Kosovës	83	183,026.41	0.022
17	CDF	4	160,682.75	0.019
